



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës**  
Ri-tenderohet projekti i rregullimit të infrastrukturës në Prevallë

*25 tetor 2012, Prizren*

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit me kërkesë të DUPH-së ka nxjerrë konkluzionin për ri-tenderim të projektit për rregullimin e infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë. DUPH-ja konsideron se tani janë krijuar rrethana të reja me miratimin e Planit Rregullues Urban, dhe me qëllim të zbatimit të këtij Plani është e nevojshme që të zgjidhen problemet e ndërtimit të vikend shtëpizave, të cilat janë evidente në këtë lokalitet.

Ekzekutivi lokal ka miratuar edhe vendimin për vlerësimin e gjendjes në kampingun e Prevallës, për të cilën gjë është formuar komisioni përkatës shtatë anëtarësh, ndërkohë që do të përcaktohen edhe kriteret e tenderit të ri për menaxhimin e kampingut në Prevallë.

Ndërsa propozimi i Drejtorisë së Administratës për furnizim me karburante për nevojat e komunës së Prizrenit ka kaluar njëzëri. Në bazë të parallogaritë të DA-së do të kontraktohen afër 340 mijë litra dizel dhe afër 25 mijë litra benzinë, për nevojat e komunës, QKMF-së, shkollat e komunës dhe të QPS-së.

Në këtë takim janë miratuar edhe propozimet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për shpalljen e tenderit për fshirjen, larjen dhe largimin e borës në hapësirat publike në qytet, pastaj pastrimi i borës në rrugët e fshatrave dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra. Po ashtu është shpallur tenderi për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Nashec, sikurse edhe ai për ndërtimin e disa rrugëve lokaleve e kanalizimeve me participim.

Ka kaluar edhe propozimi i DPMS-së për shpalljen e tenderit për kyçjen e kanalizimit të objekteve të banimit social në kanalizimin e qytetit dhe janë lejuar mjetet për organizimin e një punëtorie në nivel rajonal për hartimin e statutit të QPS-së.

Qeveria lokale i ka dhënë dritën e gjelbër edhe kërkesës së DASH-it për organizimin e një akademie solemne me të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit për nder të shënimit të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org)

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 522 199 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*